**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

KAÇANIKU

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**Kuvendi i Komunës**
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr. 060/01-20699/24**
**Kaçanik, 26.08.2024**

**FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 05.09.2024 (e enjte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli
______________________

Në mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 05.09.2024, do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, Edona Luzha;

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 6-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 28.06.2024, me vazhdime të datës 03 dhe 31.07.2024;

3. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 7-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 31.07.2024;

4. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-11622/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Elezaj, në emër të "Migros Group", me përfaqësues Mustafë Rexhepi;

5. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-12092/24, të datës 31.05.2024, për Bartjen e Mjeteve nga Rezerva Komunale sipas Buxhetit të vitit 2024;

6. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-11717/24, të datës 31.05.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore nga Burimi i Fondeve 22 - Të Hyrat e Bartura nga Viti i Kaluar 2023 në Buxhetin e vitit 2024;

7. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-14274/24, të datës 28.06.2024, për Transferin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024;

8. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/03-14313/24, të datës 28.06.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal of Kacanik**

***01Nr. 60/01-11877/24***
***Kaçanik, 31.07.2024***

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31.07 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsye: Naim Beça dhe Agim Çaka.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Valdrin Dogani –ZKF, Makfire Malsiu, Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli.
Nga OSBE, në mbledhje mori pjesë, Faruk Dërmaku dhe Arben Shehu.
Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, 2 anëtarët: Naim Beça dhe Agim Çaka me kanë njoftuar se nuk kanë mundësi me marrë pjesë në mbledhje, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 31.07.2024, me këtë:

**REND PUNE**

1. Raporti Gjashtëmujor i punës së Kryetarit të komunës, për periudhën Janar –Qershor 2024;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023;
5. Propozim Vendim për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec;
6. Informatë rreth gjendjes aktuale të furnizimit me ujë në komunën e Kaçanikut dhe shfrytëzimi i aseteve të financuara nga buxheti komunal dhe donatorët për nevojat e rrjeteve të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU ”Bifurkacioni”-Njësia e Kaçanikut.

Pika 6 ka hyrë në rend pune, me kërkesën e KK nga mbledhja e kaluar. Rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Rendin e punës prej 6 pikave.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Zakonisht Procesverbali i mbledhjes së kaluar miratohet në këtë mbledhje, mirëpo mbledhja e 6 ka përfunduar sot, kështu Procesverbali i mbledhjes së 6 të rregullt të KK, mbetet të aprovohet në mbledhjen e radhës të KK.

**Pyetje dhe Kërkesa**

**Kadrije Lika-Troni:**
1.Në mbledhjen e kaluar, kur u diskutua KBAK, me drejtorin Bahri Selimi, e ngrita çështjen e ashensorëve, se nuk ishin përfshirë në draftin kornizë. Drejtori tha se do të bëjmë një rishqyrtim të draftit. Desha me pyetur drejtorin e DSHPE: A mund të formoni një komision dhe të filloni një marrëveshje se bashku me banorët e ndërtesave për zgjidhjen e këtij problemi, se banorët po përballën me probleme të natyrave të ndryshme dhe mungesa e një ashensori e vështirëson edhe më tepër jetën e tyre?
2.Kërkesë për Kryetarin e komunës dhe drejtorin e DA. Në muajin e ardhshëm, drejtori fillon me përgatitjet për vitin shkollor. E ndiej obligim të kërkoj për herën e dytë të shqyrtoni vendimin se bashku me drejtorin Doda, që të përfshihen në mbulimin e shpenzimeve të transportit edhe nxënësit e shkollës së Gjimnazit” Skënderbeu”, për nxënësit që udhëtojnë mbi 5 km. Prindërit e nxënësve nuk meritojnë trajtim të tillë, nxënësit e komunës tonë nuk e meritojnë një diskriminim nga komuna dhe direkt nga ju kryetar. Ata duhet të trajtohen të barabartë, sepse misioni i tyre është i përbashkët, mësim nxënia. Shpresoj kërkesa ime të merret parasysh dhe vendimi të ndryshoj që t'i trajtoj të barabartë nxënësit e shkollave.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Me intereson të di, çka ka ndodhur me rrugën” Emsale Frangu” aty të shkolla në Dushkajë, edhe pse ministria i ka kthyer vendimet e KK, ju prapë se prapë keni ndërtuar në prona private. Ajo që dua të di është: Si ka mundësi të ndërtohet, kur ministria i ka kthyer ato vendimet me vlerësim negativ?

**z. Rrustem Zenuni:** Para tre muajve kam ngritur një pyetje këtu, lidhur me kërkesat që i ka adresuar komuna e Kaçanikut në ministritë e linjës, për projekte kapitale, ka qenë e hapur një shpallje publike, për investime në projekte. Përgjigje nuk kam marrë. Kërkoj të me jepet një përgjigje zyrtare a ka diçka në këtë drejtim?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkesa të tjera nuk ka, kalojmë në pikat e rendit të punës:

1. Raporti Gjashtëmujor i punës së Kryetarit të komunës, për periudhën Janar – Qershor 2024;

Materialin e keni marrë, në raport është përmbledhur aktiviteti i kryetarit, në obligim ligjor me raportuar 2 herë në vit. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky raport duhet të bazohet kryesisht në planin e ekzekutivit të komunës për vitin 2024, të bëhet dallimi në mes planit të ekzekutivit dhe realizimit të planit. Ky plan i ekzekutivit kishte si objektivë, mbështetjen e të gjithë qytetarëve me projekte kapitale dhe shërbime administrative në bashkëpunim me ministritë e linjës, komunës, shoqëria civile, për me të ofruar shërbime efikase qytetarëve. Nëse e shqyrtojmë këtë raport, shihet se objektivat për investime kapitale nuk janë realizuar në pajtim me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Kjo po ndodhë negativisht në plotësimin e kushteve dhe nevojave elementare infrastrukturore, për

të cilat qytetarët presim që mjetet e taksapaguesve, të kthehen në përmirësimin e jetës së qytetarëve, por kjo nuk ka ndodhë. Situatë e ngjashme është edhe në raportin financiar, me gjerësisht do të debatojmë kur të kalojmë në atë pikë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti ishte sa për njoftim, kështu që konstatohet se, Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje,

**NJOFTOHET**

**Me Raportin Gjashtëmujor i punës së Kryetarit të komunës, për periudhën Janar – Qershor 2024/ Lënda: 01Nr. 104/02-17115/24.**

**2.** Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është në pushim, ndërkaq është Valdrin Dogani-ZKF, për sqarime të nevojshme. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Raporti është një dokument i rëndësishëm, i cili ofron një përmbledhje të përformancës së qeverisë lokale. Ky raport ka për qëllim të jep një pasqyrë të hyrave dhe shpenzimeve dhe balancimin financiar të komunës për periudhën, janar-qershor 2024. Raporti financiar duhet t'i ketë për bazë, planifikimin, buxhetin apo ndarjen buxhetore nëpër kategori dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore. Në raport përfshihen, zakonisht, të ardhurat, shpenzimet, thesari dhe përmbledhje e përgjithshme. Të ardhurat përfshihen, taksat komunale, subvencionet nga niveli qendror dhe të ardhura të tjera. Duhet të fokusohemi të HVK, pasi të hyrat tjera janë të ndikuara nga grantet e përgjithshme, të arsimit, shëndetësisë. Buxheti i tanishëm, është mbi 12,826,840.42€, është një ndër buxhetet me të mëdha që ka pasur komuna ndonjëherë. Inkasimi i të HVK që i takon komunës është jo e kënaqshme në raport me vitet e kaluara. Nga 924,200.00 € të inkasuar, vetëm 350,713.65€, ose 38%, ndërsa të HVK të bartura nga vitet paraprake nuk janë të sakta, me atë që janë paraqitur të raporti financiar 2023. P.sh. bartja e mjeteve sipas raportit 2023, thuhet se bartën 1 milion e 98 mijë euro për vitin 2024 nga viti 2023, ndërkaq po i bartni vetëm 867 mijë euro. Besoj se duhet të qartësohet kjo bartje, se ku kanë ngel mjetet tjera, se këto mjete janë para të qytetarëve dhe duhet me i dhënë llogari qytetarëve. Të Bartja e të HVK, nuk e di sa iu kujtohet, unë zakonisht kam parë edhe shkëmbime me emaile se ka qenë një paqartësi në mes drejtorit - ekzekutivit dhe neve si opozitë. Asnjëherë nuk kanë dërguar atë që e kemi kërkuar ne, Raportin e IK. Unë e kam thënë në atë raport se në vitin 2024 do të bartën 867 mijë euro, drejtori i financave ka qenë kundër, sepse ka proklamuar në raport gjoja se unë nuk jam njohës i mirë i financave. Unë jam inxhinier, por jam i saktë në shifra. Janë dëshmitë, kjo është dëshmia e mjeteve të bartura nga viti 2023 në vitin 2024. Janë bartur 1 milion e 98 mijë euro, ndërsa të hyrat e vitit 2024 figurojnë vetëm 867 mijë euro. Këtu duhet me dhënë sqarim ku kanë mbetur edhe 230 mijë euro. Tjetër, keni bërë ndryshim të planifikimit dhe realizimit. Unë mendoj se planifikimi për vitin 2024 bëhet njëherë në vit, mund të ndryshohet realizimi, por në këtë rast ka ndryshim edhe në planifikim. Të Mallrat dhe shërbimet, drejtori nuk është këtu, është mirë të na e sqarojnë zyrtarët apo kushdo tjetër, se ku kanë mbetur edhe 230 mijë euro të cilat mjete nuk janë bartur në vitin 2024? Të Mallrat dhe shërbimet e keni me lehtë me i shpenzuar mjetet, mirëpo prapë nuk është e kënaqshme, se shpenzimet me të mëdha po bëhen të mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale. Shuma për mirëmbajtjen e rrugëve lokale 179,798€ është marramendëse, duke pasur parasysh se dimri nuk ka qenë me borë, rrugët aktualisht nuk janë pastruar, mund të dalim e i shikojmë, shihet se rrugët janë në gjendje të mjerueshme, nuk është pastruar asnjë rrugë, ndërkaq mjetet po shkojnë. Dilni në teren, shikoni rrugën për Kovaçec, rrugën për Dushkajë dhe rrugët tjera nuk janë pastruar, trotuaret janë mbuluar me bari e ferra, ndërkaq në anën tjetër, mjetet janë shpenzuar 180,000€. Të gjykatat, janë shpenzuar diku 27,000€, kjo është një papërgjegjësi e madhe e ekzekutivit që nuk iu dhimbën mjetet e qytetarëve dhe i paguajnë gjykatat. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale për vitin 2024

keni paguar 99,000.00 €, ndërkaq 38,000.00€ i keni lënë për vitin e kaluar, se është një kontratë që duhet të përmbushet, mirëpo shqetësuese është se inflacioni ka qenë 25,000.00€, është shqetësuese të paguhet për një vit inflacion kjo shumë e mjeteve. Shumat tjera që janë paguar nga gjykatat, 12,000.00€ të kontrata vjetore e mirëmbajtjes se rrugës, që keni paguar me përmbarim, kjo është shqetësuese. Përpos që po paguani shuma të mëdha edhe po ndëshkoheni. Të IK, nga 3,387,805,29€ që është planifikuar, janë realizuar 506,471.92.00€ apo vetëm 13 % për 6 muaj. Nëse vazhdohet me këtë trend, nuk arrin realizimi as 50% me u shpenzuar për IK, mirëpo mendësia e juve sikurse hera tjera keni me arritur me realizuar, por sikur hera tjera raporti nuk del i mirë, se do të jepen aneks kontrata, projekte pa mbikëqyrje dhe do t'iu kushtoj me tepër mirëmbajtja sesa asfaltimi i rrugëve. Të subvencionet dhe transferet, me planifikim që parashihet komuna jonë me bërë një zhvillim ekonomik, subvencionet i keni zero, të DBPZHR, është shqetësuese, ndërkaq e vetmja mundësi e pozitës së komunës tonë që ka, duhet me u fokusuar shumë në zhvillimin e bujqësisë. Subvencionet dhe transferet në këta 6 muaj, janë zero. Mund të jepni subvencione tutje, mirëpo me pasur mundësi me i shfrytëzuar qytetarët, subvencionet nuk jepen në fund të vitit. Të DKRS, kjo drejtori u mundua pak a shumë me shpërndarë subvencione të gjitha kategorive nga pak, por nuk e di a ka pasur prioritet se cili është prioritet i kulturës në komunën tonë. Shembull po e marrë, KF "Lepenci" i janë ndarë vetëm 10,000.00€, këtu shihet serioziteti i komunës për me i subvencionuar klubet sportive. Kështu ka ndodhur në vazhdimësi, për këtë arsye klubi është në këtë gjendje.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Për hir të transparencës, nëse janë në gjendje kryetari apo nënkryetari me na sqaruar, se nuk është shumë e vogël, se mos prezenca e drejtorit na vënë në dyshim me dyshuar. Tjetra: Edhe në KPF e diskutova çështjen e taksave tjera administrative, a duhet me pasur emër këto taksa se çfarë janë, qysh kategorizohen këto taksa. Të drejtoria për Buxhet dhe Financa, realizimi i këtyre të hyrave për 6 muaj është mbi 29,562.29€, ndërkaq planifikimi është 1000€. Nëse keni mundësi me na sqaruar, se është një shumë bukur e madhe e këtyre të hyrave.

**z. Valdrin Dogani:** Taksat që hynë të drejtoria e urbanizmit me mirë mundet me ditur drejtori i DUKMM. Këtu hynë taksat për leje ndërtimi, regjistrimin e trashëgimisë, dm.m.th përfshijë ato taksa që emërtimet nuk janë këtu. Ne punojmë me sistemin e intranetit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në mbledhjen e KPF drejtori e ka shpjeguar dhe ju keni qenë aty. Të taksat tjera administrative hynë certifikatat e pronësisë, të cilat nuk kanë kod të veçantë, por janë të grumbulluar në një kod buxhetor, si taksa tjera administrative, të cilat taksa mblidhen sipas rregullores që e kemi për taksa dhe tarifa. Nëse donë dikush me në detaje se cilat taksa dhe sa, atëherë me detajesh mundet me iu informuar të drejtori me në detaje se cilat taksa hynë në këtë kod buxhetor dhe grumbullimi i tyre. Në këtë kod buxhetor hynë taksat jashtë asaj që janë planifikuar, siç janë lejet e ndërtimit, taksat për certifikatë të pronës etj.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Të emërtimi i të HVK kemi në total të HVK të DBF dhe të DUKMM. Kur jemi të DBF, kemi taksa tjera administrative që është planifikimi 1000 €, ndërkaq realizimi 29,562.29€. Unë po kërkoj me ditur se cilat taksa janë, se është dallim i madh në mes planifikimit dhe realizimit dhe këto mjete duhet me pasur kod buxhetor, që edhe taksapaguesi që paguan, me ditur vinë ato mjete dhe ku shkojnë këto mjete.

**z. Agim Mani:** Nëse ju e dini, e përgjigjesh, nëse nuk e din, nuk është mirë me u përzier në punët e ekzekutivit. Nëse anë planifikuar me pak mjete, e janë realizuar me tepër, kjo është keq planifikim. Nëse pajtoheni me këtë, në rregull është, por çështja është se ka ndryshuar edhe planifikimi në raportin 3 mujor financiar, kjo nuk është e drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse e shikojmë rregulloren e taksave dhe tarifave, ka shumë taksa dhe tarifa të listuar.
**znj. Kadrije Lika-Troni:** Nëse nuk ka mundësi kryetari dhe nënkryetari me u përgjigjur në pyetjen e Agimit se ku kanë mbetur shuma e mjeteve, 230,000€, atëherë drejtori i DBF, duhet me na ardhur në mbledhjen vijuese me raport, se është vlerë e madhe shuma 230,000€. Drejtori kur të sjellë raportin këtu, duhet me qenë prezentë.

**z. Agim Mani:** Nuk është mirë me neglizhuar, kur unë e kam thënë se nuk mundeni me i bartur 1 milion euro, se nuk i keni, drejtori ka thënë se i kemi të alokuara dhe kemi me i bartur. Tani po del se unë kam pasur të drejtë dhe kam kërkuar, dhe këtë kërkesë ia kam adresuar të gjithë anëtarëve të KK dhe anëtarëve të ekzekutivit.

**z. Qamil Stagova**: Sa i përket inkasimit të mjeteve nga DUKMM, nuk i kam tani informata, për mbledhjen vijuese do të jap sqarime të nevojshme.

**Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Se qysh janë shpenzuar mjetet, e kemi raportin e auditorit, që është më i miri deri tani, për detaje tjera, mundeni me shkuar me kërkuar informata shtesë në drejtori. Të dhënat e paraqitura në raport, janë zyrtare, ndërkaq çështja është se po bëni filma, po mundoheni me i shfrytëzuar kamerat këtu para qytetarëve. Të taksat tjera administrative, janë në kuadër të drejtorisë urbanizmit, planifikimi është 1000€, realizimi, 29,000€, këto mjete janë me letra të dokumentuara. Drejtori nuk është këtu, por ua dërgon me email. Të shpenzimet, e theksuat se realizimi është i vogël të IK, por është periudha që shpenzohen me pak mjete. Gjithçka është me letra. Drejtori është në pushim, mirëpo për çdo paqartësi, që mendoni se është keqpërdorë diçka, mundeni me ia adresuar kërkesat drejtorit.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne si LDK iu mbajmë për fjale për realizimin e dobët të buxhetit që ju edhe vet e theksuat. Ky realizim i dobët, kritika jonë edhe gjatë vitit të kaluar me gjasë, ju ka bërë mirë edhe pushtetin se e keni bërë realizimin, kështu që ne jemi këtu me iu mbajtur për fjale për të cilat ju i thoni. Gjatë kësaj periudhe, realizimi i buxhetit është i vogël, uroj në periudhën vijuese të jetë realizimi me i mirë, në mënyrë që të mirat e investimeve t'i merr secili qytetarë. Edhe në KPF është diskutuar inkasimi i të HVK i ulët, ku është thënë edhe në raport, nga mos dhënia e lejeve të ndërtimit nga DUKMM. Inkasimi i dobët është edhe si rezultat i PZHK, i cili plan po e lënë peng komunën tonë edhe për ndërtime të larta, ku si rezultat i kësaj, qytetarët detyrohen të lëshojnë vendin dhe të shkojnë në komuna tjera. Këtë e dëshmon edhe numri rezidentë i qytetarëve të komunës tonë me regjistrimet e popullsisë të këtij viti. Uroj që kryetari, nënkryetari ekzekutivi i komunës në përgjithësi, ne anëtarët e KK, me marrë përgjegjësinë e cila na takon, me punuar me shumë në hartimin e PZHK, për arsye se pasojat e PZHK i bartin jo vetëm qytetarët, por secili nga ne, ju që jeni në pushtet sot, dhe nesër që pretendojmë me qenë ne. Kjo është një kritikë për krejt neve, se nuk jemi duke bërë sa duhet në hartimin e PZHK për lehtësimin e jetës së qytetarëve, për arsye se ato po e gjejnë vetën në komuna tjera, ku po popullohet Ferizaj me banorët e komunës tonë.

**z. Agim Mani:** Po ndërlidhë me fjalën e Nënkryetarit, i cili theksoj i cili tha po bëni filma, ne nuk jemi aktor. Unë kërkova sqarime, sqarimet janë për qytetarët, se qytetarët duhet me ditur se ku po shkon çdo cent. Nëse doni me bërë mjegullina, me dalë krejt prej temës, ajo është diçka tjetër. Unë po flas me fakte zyrtare, të cilat i kam nxjerrë nga raporti financiar i vitit 2023 dhe çështja është se kanë diskrepancë njëra me tjetrën. Për këtë jam duke kërkuar sqarim. Të HVK të vitit 2023 dhe 2022 në total janë 1 milion e 900 mijë, 890 mijë janë realizuar, 1 milion e 98 mijë mbesin të bartën në vitin 2024, nuk i keni bartur, ju i bartni 867 mijë euro. Këtë e kam vërejtur në raport vjetor financiar, por asnjëherë nuk keni kthyer përgjigje. Pse nuk po i bartni 1 milion, por 800 mijë? Kërkoj përgjigje, nëse nuk i dini, duhet me treguar se nuk i dimë.

**Nënkryetari i Komunës:** Unë nuk po hy në detaje, ju po kërkoni se ku janë 230,000.00€. Ju jeni opozitë dhe nuk shihni bardhë, vetëm zi. Para qytetarëve e ndijë obligim të sqaroj se çdo gjë është transparente, janë të publikuara. E përmendet çështjen e subvencioneve, i përmendet të gjitha kategoritë, ndërkaq nuk e përmendet që asnjë investim nuk e kemi si komunë. Ju na keni thënë: A jeni ju të përgatitur si ekzekutiv për projekte në investime kapitale? Ne i kemi dërguar 5 projekte me rëndësi vitale në ministri të linjës, asnjë nuk na është përgjigjur pozitivisht. Pse nuk bëni ju presion në ministri me përfituar ndonjë investim, si çështja e kolektorit për ujëra të zeza e shumë projekte tjera. E ndiej obligim çështjen e PZHK, se Ardita e ke potencuar shumë herë, e ndiej obligim me sqaruar para qytetarëve, çështja është në mungesë të përgjigjes nga ministria për VSM. Projektet janë në ministri, PZHK ka me dalë përsëri në diskutim publik. Për ata që donë me ndërtua, i kemi me lista në hartë se ku munden me ndërtuar, me ligj, në 50 metra nuk munden me u ndërtuar. Çështja është se pa marrë përgjigje për VSM, nuk po mundemi me procedua me PZHK. Fajet i dimë të gjithë, për VSM Hanit të Elezit i kthehet përgjigja shumë shpejt, ndërkaq neve ka 2 vite që është dërguar në ministri dhe nuk kemi përgjigje.

**znj. Ardita Rrahmani:** Lidhur me vonesat e hartimit të planeve zhvillimore, VSM dhe PZHK, kjo nuk e amniston komunën, por nuk e amniston as nivelin qendror-ministrinë, pavarësisht se kush është në pushtet.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Se pari Kryesues nuk munde me dënuar gjuhën e nënkryetarit me na thënë neve se po bëni filma. Nëse nënkryetari është i emëruar prej kryetarit, ne jemi të emëruar prej popullit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse duhet me dënuar gjuhën, nuk e di se prej kujt duhet me ia nisur?

**z. Burim Shehu:** Po ndërlidhem të subvencionet dhe transferet të cilat iu kanë ndarë KF" Lepenci", shuma 10 mijë euro, ky klub para 10 viteve ka qenë në super ligë, ndërkaq tani po shuhet ky klub. A bënë me ditur, a nuk ka mundësi me shumë me ndarë mjete. Unë mbajë mbledhje me ta, ata me kanë thënë me iu pyetur çka është problemi të ky klub, se dita ditës është në shuarje, ndërkaq ka klube që janë me të dobëta se ky klub dhe janë në ligë.

**z. Kadri Krivenjeva:** Kërkoj të nisemi ne nga veti, a jemi ata që i kemi kryer obligimet tona komunale të taksave dhe tatimet, pastaj i shikojmë të tjerët.

**z. Agim Mani:** Ne duhet të kuptojmë një çështje, pse jemi ne këtu prezentë. Ne jemi këtu, me kërkuar llogari nga ekzekutivi për qytetarët. Ne nuk jemi me mbrojte interesin tonë personal, pavarësisht sa i kemi kryer obligimet tona. Ne po flasim për interesin e përgjithshëm të qytetarëve, interesin e qytetarëve e mbron ekzekutivi i komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për çështjen që e ngriti Burimi, kjo na brengosë të gjithëve, ne edhe privatisht i kemi marrë disa iniciativa për me gjetur forma që me ndihmuar përmes bizneseve. Nënkryetari është me në rrjedha me na dhënë sqarime të nevojshme.

**Nënkryetari i Komunës**: Po iu sqaroj për hire të qytetarëve, se për KF"Lepenci" janë ndarë 17,700 €, do të ndahen në pjesë. Nëse i marrim në total shumën e përgjithshme të subvencionet në kulturë, është 30% e mjeteve. Lepenci është OJQ, jemi munduar me ndihmuar aq sa kemi buxhet, përkundër gjendjes se klubit, ata e kanë lënë klubin pa asnjë borxh, d.m.th. nuk e kanë asnjë obligim financiar. Drejtoresha mundet me na sqaruar me në detaje. Ne nuk guxojmë me u përzier në politikë të klubit. Është ligji për sponzorizim të klubeve sportive që e definon subvencionimin e klubeve, që bizneset që kanë tatim në fitim, munden 30% të mjeteve mos me

ia dhënë ATK, por ndonjë klubi sportiv, kjo është çka ministria ka mundur me bërë për sponzorizim të KS, ndërsa çështja sa ecin këta për klubin, është diçka tjetër.

**z. Burim Shehu:** Po ju kuptoj juve, pyetja tani është për drejtoreshën e DKRS: A janë duke bërë kryesi të klubit apo jo. Nëse nga viti në vit janë ndarë mjete në shumë të njëjtë, atëherë ne jemi në rënie, ndërkaq drejtoresha duhet me i shikuar çështjen e sponsorëve të bizneseve që me sponsorizua 30% të tatimit në fitim, ose duhet me bërë diçka tjetër se klubi është në rënie.

**znj. Hafize Sallahi:** Unë bashkë me Kryetarin dhe Nënkryetarin nga fillimi i mandatit jemi marrë me KF" Lepenci" edhe pse nuk është në domenin tonë me zgjedhë ne kryesinë. Klubi është një OJQ i pavarur sikurse të gjitha klubet tjera sportive, subvencionohen nga komuna dhe për mos me përsëritur fjalët e nënkryetarit se sa buxhet ndajmë për klubin, që shpesh herë edhe kemi marrë reagime nga klubet tjera, sepse edhe ata të tjerët i thonë vetit sportist. Pajtohem me mendimin e juaj, që KF "Lepenci" e donë të gjithë, nuk jemi ithtarë të shuarjes së këtij klubi. Edhe pse nuk na përket, unë kryetari, nënkryetari që 1 javë jemi duke u marrë me këtë çështje, por nuk jemi ne ata të cilët duhet me bërë kryesinë. Me keqardhje e themi që ajo kryesi e klubit e ka ofruar një dorëheqje përmes rrjeteve sociale, që ata të cilët merren me sport e dinë me mirë a është dashur dorëheqja me u dhënë në atë formë. Nga informatat që i kemi, klubi nuk ka asnjë borgj, se me herët ka qenë në borgje. A duhet kryetari e drejtoresha me bërë kryesinë, nuk jemi ne ata që duhet me bërë kryesinë. A duhet çdo qytetarë të ndihmoj që klubi të shkoj përpara, duhet. Sa i përket çështjes se a i keni informuar bizneset, ne kemi mbajtur takime me biznese, ku i kemi njoftuar rreth ligjit të sponsorëve të klubeve sportive. Ata janë arsyetuar se klubi nuk ka qenë i licencuar, ndërkaq tani klubi i ka të gjitha dokumentacionet. Ndoshta nuk është etike, por unë dhe nënkryetari jemi duke zhvilluar takime me bizneset, këtë ta kuptojnë edhe qytetarët. Etike është që çdo qytetarë të merret me klubin "Lepenci", nëse vërtetë e duan këtë klub. Ne jemi duke e dhënë maksimumin, jemi në bisedime, besoj që se shpejti do të zgjidhet kryesia, ka lojtarë, se nuk është e vërtetë që po thuhet në rrjete sociale se nuk ka lojtarë, klubi nuk është në shuarje, i mungon kryesia, se shpejti do të formohet, por ne pa ndihmën e bizneseve, gjithë qytetarëve të Kaçanikut, se klubi sportiv me këtë subvencionim nuk mundet të ekzistoj. Momentalisht është kjo shumë e mjeteve me buxhet, 10 mijë euro faza I, pjesa tjetër në fazën tjetër. Në vitin tjetër mund të këtë ndonjë ngritje të vogël të subvencioneve për klubin, por momentalisht janë 17,700.00€. Shuma 7,700€ bartet në sezonin e dytë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Nëse mundesh drejtoreshë me na shpjeguar, KF" Lepenci" është OJQ, kuptohet, por ky klub është i lidhur me komunën në krahasim me OJQ tjera. Për atë ju po dilni po kontaktoni bizneset, po doni me ri këmbë KF" Lepenci". A mundesh me na i sqaruar me në detaje, KF"Lepenci" karshi klubeve tjera sportive dhe OJQ-ve tjera, çka ka të bëjë me komunën?

**znj. Hafize Sallahi:** Realisht KF "Leepenci" është i regjistruar si OJQ në komunën e Kaçanikut, njëjtë si klubet tjera sportive. Gëzon të njëjtin status, sikurse klubet tjera sportive, si basketbollit, hendbollit që i kemi. E theksoj edhe i nderuari, që e donë një mbështetje dhe unë jam e pajtimit. Për ne janë të njëjta të gjitha klubet sportive, sepse gëzojnë të njëjtin status. Ne, të bizneset nuk lobojmë vetëm për një klub, ne kemi mbajt debate publike me bizneset, ku ua kemi sqaruar ligjin për sponsore, që vlen për të gjitha klubet.

**z. Bashkim Luma:** Kur jemi të KF "Lepenci" vlen të përmendet stadiumi i qytetit, që sa vite ka filluar, por nuk ka asnjë investim të duhur aty. Është mirë me na treguar kryetari, ekzekutivi i komunës, që sa vite ka filluar stadiumi i qytetit dhe pse nuk ka përfunduar?

**z. Agim Mani:** E përgëzoj drejtoreshën, që ndoshta e ka dhënë maksimumin për funksionalizimin e KF "Lepenci", ndoshta e ka dhënë maksimumin, aq është kapaciteti deri

këtu, por nuk sqaroj cili është plani për me aktivizuar klubin. Në këtë rast ju po del se jeni dorëzuar dhe nuk keni arritur me funksionalizuar klubin.

**znj. Hafize Sallahi:** I nderuar Agim, unë nuk thashë se jemi dorëzuar, unë e potencova se paraprakisht jemi në bisedime, nuk është në domenin tonë me formuar kryesinë e klubit, por për shkak të dashamirësi sisë që kemi për këtë klub sportiv, jemi duke bërë edhe atë që nuk na takon.
**z. Agim Mani:** Nëse e keni hënë maksimumin, rezultati është ky, lojtarët e KF ”Lepenci”, simpatizantët “Fikshat”, nuk kanë çka me pritur me tepër nga ju.

**znj. Hafize Sallahi:** Agim, a je qytetar i Kaçanikut, a e donë KF “Lepenci”? Edhe ju me qenë kryetar, nuk mundeni me subvencionuar me tepër këtë klub, sepse ka edhe klube të tjera që e gëzojnë të njëjtin status. Gjeni mënyrën sot, ne të gjithë si qytetarë i bashkojmë financat për klubin lepenci, dhe ju e dini fort mirë sa financa i duhen një klubi për me garuar në ligën e parë.
**z. Agim Mani:** Cila ka qenë gjendja e KF ”Lepenci” para 12 viteve pa ardhur kryetar Besim Ilazi, cila është sot? A ka pasur me shumë financa sesa sot? KF “Lepenci” ka qenë në ligën e parë para 12 viteve, mirëpo përkushtimi ndaj këtij klubi, të cilit iu ka mohuar e drejta e terrenit, ka ardhur klubi në këtë gjendje, është degraduar. Ky është shqetësimi ynë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Suksesi dhe mossuksesi padyshim se inkorporon edhe me mbështetjen që merr nga institucionet, qoftë nga federata apo komuna, por suksesi dhe mossuksesi varet edhe nga vet përformanca e klubit dhe udhëheqja e klubit. Të gjithë e potencuam se klubet sportive janë OJQ, se ashtu janë të rregulluara në Kosovë që klubet sportive e kanë këtë status. Nga koha kur unë jam në KK, KF ”Lepenci” është subvencionuar çdo vit në maksimum nga 17.000.00 deri 20.000.00€. Ky është maksimumi që ka mundur komuna me dhënë. KF ”Lepenci” nuk ka pasur mjete me tepër as kur ka qenë në ligë të parë. Ne nuk mundemi me shumë, por e kemi vullneti me u bashkuar me secilin për me i bashkuar forcat, qoftë si qytetarë, apo biznese, që me arritur atë që duam për këtë klub sportiv. Institucionet e kanë obligim me ua krijuar kushte infrastrukturore të nevojshme. Në këtë aspekt drejtoresha ua ka hequr shpenzimet e udhëtimit, është blerë një kombibus e do shpenzime tjera, që me u reduktuar shpenzimet e udhëtimit. Ka biznese që munden me mbajtur gjallë klubin, ndërsa a për-formon mirë apo keq nuk varet krejt nga ajo që ne e mbështetim.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne jemi rritur me KF ”Lepenci”, dashuria që e kemi për atë klub, jo që nuk e kemi edhe për klubet tjera, por si fëmijë kemi shumë kujtime në stadiumin e qytetit. Teposhtën ky klub e ka bërë me bartjen e tyre në stadium tjetër. Personalisht e kritikoj dhe nuk kam qenë asnjëherë në atë klub. Është një OJQ, padyshim që është vullnet i secilit qytetar me pa klubin aty ku e ka vendin. Unë kam kujtime shumë të mirë kur ky klub ka fituar lojën dhe ka hyrë në super ligë, dhe i ka dhënë jehonë të madhe vendin, kjo na mbetet në kujtime për tërë jetën. Përgjegjësia e këtij klubi është e secilit nga ne, nisur nga secili anëtar i KK, se shkojmë i shikojmë ndeshjet në ligën e 3 apo në të 4. Disa nuk e dinë as kush ka qenë kryetar i klubit, sot klubi nuk ka kryetar, por vlen të përmendet se shumë djem hapat e parë i kanë marrë në këtë klub dhe sot janë në ekipe shumë me të mëdha. Kjo të jetë një kritikë qe secili nga ne, me dhënë kontributin për këtë klub, aty ku kemi mundësi, se nëse e duam këtë klub sportiv, atëherë duhet të punojmë për të. Kjo nuk e amniston asnjërin prej neve nëse nuk marrin veprime të nevojshme me ndihmuar këtë klub.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne mundemi me fol shumë për këtë çështje, por me mirë me fol pak e me punuar shumë, me ndihmuar këtë klub, qoftë në terren, qoftë përmes bizneseve. Komuna kaq i ka mundësitë.
**znj. Hafize Sallahi:** Faleminderit Ardita, me keqardhje i themi sidomos për Agimin që theksoj se prej kur ka ardhur kryetar Besim Ilazi, ka ra klubi nga liga. Kryetari Besim Ilazi nuk është

futbollist, por është doktor. Po me vjen çudi, ku asnjëri nga ju, nuk e mori fjalën e më thënë hajde të bëhemi bashkë e të ndihmojmë klubin. Si grupe parlamentare, mundeni me marrë iniciativa, se jeni të zgjedhur të popullit, se KF ”Lepenci” i duhen për një ditë 130,000.00€ për me garuar për ligën e parë. Ky sqarim nuk ishte për publik, por po e jap. Kaq ka buxhet, nëse ju jeni të pajtimit me i diskualifikuar klubet tjera, ia qesim mjetet vetëm KF ”Lepenci”, vendosni ju, se ne nuk e kemi atë të drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komuna ka rregullore për subvencione. Ne shpesh duke u nisur nga entuziazmi dhe dëshira e këtij klubi me parë sa me lartë, shpesh herë iu kemi hyrë në hak sportistëve tjerë, se kemi nga klubet tjera apo sportist tjerë që i kanë sjellë medalje e çmime komunës së Kaçanikut, e ne nuk kemi mundur ndoshta me i përkrahur me subvencione, se futbolli është klub që ka me shumë shpenzime dhe e identifikon Kaçanikun me tepër se tjerët. Megjithatë, ka klube të mira të tjera sportive që meritojnë të përkrahen, por buxheti i komunës është ky, mundësitë janë këto. Në anën tjetër, kontributet me ndihmuar klubin në formë private, nuk na pengojnë, qoftë bashkërisht apo në formë individuale, qoftë për lëvdata, për me ndihmuar rimëkëmbjen e këtij klubi.

**znj. Hafize Sallahi:** Një sqarim, nuk po e dini në cilën ligë është KF “Lepenci’, ky klub sportiv ka ra në ligën e 2, ndërkaq është në vendin e 7.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Unë e kuptoj rolin e opozitës se ka rol kritikues, mirë që na kritikoni se erdhe ne jemi njerëz që gabojmë, kemi të meta. Ata që kanë mundësi si opozitë, është mirë me na ndihmuar, e jo vetëm me kritikuar. Të pyetja e Bashkimit, Stadiumi ka filluar në vitin 2029, pastaj ishte çështja e pandemisë, inflacioni që kompanitë kishin probleme. Unë po e bëjë një pyetje: Cili është problemi që shkolla në Doganaj, ka mbetur pa u përfunduar? Është rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Nëse doni e bëjmë një rregullore vetëm për KF ”Lepenci”, unë jam me juve. Kur jemi të stadiumi, kemi klub në vend, që nuk e kanë stadiumin e vet, por që janë në super ligë. Ne kemi bërë disa lëvizje, është bërë halla sportive, është blerë një kombi bus. Tani kur janë kushtet me të mira, klubi i Hendbollit po shuhet, për shkak se mungon vullneti i njerëzve të mirë me u marrë me këtë sport. Ne si komunë kemi bërë atë që kemi pasur mundësi, i kemi mbështetet klubet me kapacitetet që kemi, ndërsa ndërhyrje nga komuna nuk ka në klubet sportive. Me një vullnet të mirë të gjithë qytetarëve që e duan sportin, unë mendoj se ky klub ka me arritur aty ku duam ne, se ky klub meriton me qenë në ligën e parë.

**z. Selajdin Troni:** U diskutua shumë për KF ”Lepenci”, për me pasur kryesinë klubi. Me bërë ne kryesinë, thoni se i keni bërë njerëzit e juaj, kështu po e marrë si iniciativë, po bëhemi ne bashkë po e dërgojmë një kryesi.

**z. Agim Mani:** Ne nuk jemi për me u bërë bashkë me formuar kryesinë e klubit.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E pyes drejtoreshën, a ka ligë me poshtë se ku është KF ”Lepenci”?. Minibusin që e keni blerë, a është funksional apo jo dhe a ka shofer të veçantë?

**znj. Hafize Sallahi:** Një sqarim, minibusi është i regjistruar, i kompletuar me dokumente, është funksional për të gjitha OJQ, me datë nuk e di, por nga momenti kur është bërë regjistrimi, që 2-3 muaj është funksional. Shofer të posaçëm nuk ka, jemi duke punuar me autorizim. Ligë me poshtë se KF ”Lepenci”, ka.

**z. Rrustem Zenuni:** A jemi në pikë për raport financiar, se diskutimi po bëhet sikur me qenë në raportin e punës se kryetarit, u devijua pika. Besoj se nuk e paskeni lexuar raportin financiar. Nëse ka nevojë e bëjmë një pikë të veçantë të DKRS dhe debatojmë vetëm për atë pikë. Kur jemi të raporti financiar, të HVK kanë shënuar rënie, por sipas argumentimit të drejtorit, është heqja e kufizimit të qytetarëve për regjistrim të automjeteve dhe tjera, me Ligjin e tatimit në

pronë, është rritur vlera e objekteve nga 15.000.00-30,000.00€ të objekteve që nuk hyjnë në tatim, e që përfshijnë një numër të madh të objekteve. Sqarimi i drejtorit thoshte se edhe kjo ka ndikuar shumë në inkasim të ulët.
**znj. Ardita Rrahmani:** Mos thoni se nuk e kemi lexuar raportin financiar, unë diskutova në raportin financiar, por ju nuk paskeni dëgjuar, në këtë rast pozita nuk po dëgjon, pikërisht këtë që e diskutove.
**z. Rrustem Zenuni:** Nuk e keni thënë këtë që e diskutova unë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kur jemi të subvencionet, për 6 muaj nuk keni subvencionuar dy kategori, të cilat për mua janë shumë të rëndësishme. Në planifikimi të zhvillimit ekonomik, 0 subvencione për 6 muaj. Edhe në bujqësi, 0 subvencione për 6 muaj. Kjo mungesë e subvencioneve do ndikoj keq dhe me pasoja për qytetarët e komunës tonë. Bujqësia si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Kaçanikut, është lënë pa mbështetje, fermerët përballën me vështirësi për me mbajtur familjen dhe siguruar jetesën e tyre. Mungesa e ndihmës në zhvillim ekonomik, po afekton për ndërtimin e një të ardhme me të mirë për të gjithë ne. Ku theksova me herët se mungesa e subvencioneve në këto kategori ka me pasur pasoja, e theksova edhe me herët, 27,700 banorë nga 33.408 banorë, minus 6 mijë banorë me pak. Nuk e di për ju kryetar a ka qenë shqetësuese, dhe ky është tregues i qartë se nuk po funksiononi ashtu siç duhet. Faktorët janë të shumët, ndër ta është mungesa e ujit të pijshëm. Në shekullin e 21 ende përballemi me mungesën e ujit të pijes. Faktorë tjetër është, mungesa e infrastrukturës, po boshatisen fshatrat: Kërbliq, Gurgjedell, Kotlinë, Ivajë. Është mbyllë shkolla në Kotlinë. Jemi ndër të paktat komuna që nuk kemi mbështetje për nënat lehona. E cekem edhe me herët, ndihma jo e mjaftueshme e KF ”Lepenci”, papunësia, si rezultat i kësaj, shumë qytetarë kanë zgjedhë rrugë tjetër. Kryetar, a keni menduar për këta faktorë dhe për këtë gjendje të krijuar?

**Kryetari i Komunës:** Po me vjen mirë që nuk po shqetësoheni për 13 vjet që kemi mbi 5 mijë banorë me pak, e nuk po shqetësoheni për 200 mijë banorë që kanë ikur për 2 vjet. E dyta, Gjurgjedelli dhe Kotlina, kanë infrastrukturë të mirë rrugore në vitin 2010, kjo është mundësia e komunës. Në Gjurgjedel, të secila shtëpi është asfalti. Kjo është detyrë e kryetarit të komunës, kjo është mundësia, nuk kam çka me bërë me shumë me buxhetin që e kemi. Buxheti i komunës është 3 milion euro për investime kapitale. Me tregoni mua, si mundësh me ndihmuar qytetarëve me këtë buxhet, se nevojat dhe kërkesat janë edhe për 50 milion. Kur i përmende subvencionet të bujqësia, me u duk e padrejtë, se nëse për diçka jam krenar në mandatin tim, jam se e kemi ndihmuar bujqësinë. Tjetra, ka ankesa në procedura të prokurimit nganjëherë, besoj se nuk do të shkoj shumë kohë dhe do të shpërndahen subvencionet, se i kemi ankesat që 6 muaj, brenda 10 ditëve besoj që ndahen, kështu që mos u ngutni në këtë drejtim. E njëjta çështje është edhe të zhvillimi ekonomik. Ne nuk lidhemi me data, por me vite, nganjëherë edhe viti po është i vogël për shkak të ankesave të operatorëve, siç e kemi rastin të ndriçimi publik në Ivajë, që 2 vite jemi në ankesa në OSHP me operatorin ekonomik. Unë operatorit që është ankuar çka me i bërë, nuk mundem me shkruar në raport se u ankuar në operator. A e dini ju kur fillojnë procedurat, kur procedohet buxheti?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Raporti është 0 subvencione në bujqësi dhe 0 në zhvillim ekonomik. Kryetar a keni menduar për këta faktorë dhe për këtë gjendje të krijuar?

**Kryetari i Komunës:** Përgjigje është, në vitin e kaluar e kemi shpenzuar buxhetin 99.97%. E dyta, e kemi pasur opinionin me të mirë në raportin e auditorit që ekziston, “Opinion i pamodifikuar, pa theksim të çështjes”. Mos u lidhë me muaj asnjëherë, se procedurat e ankesave janë bërë aq të mërzitshme sa që nuk po di as vet çfarë përgjigje me të dhënë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A e dini pse ka ankesa? Sepse nuk ka kontrata njëburimore. Diskutime të tjera nuk ka, raporti ishte sa për njoftim. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**NJOFTOHET**

**Raportin Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024/ Lënda: 01Nr. 060/01-16666/24.**

**3.** Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;

Materialin e keni marrë, raporti diskutohet në KK, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Raporti është dokument që vlerëson saktësinë, transparencën dhe mbulueshmerinë e pasqyrave financiare të komunës. Ky raport është i rëndësishëm, për me u siguruar që pasqyrat financiare pasqyrojnë një mënyrë të saktë dhe të ndershme situatën financiare të komunës dhe janë në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjor. Raporti përmban, opinionin, rekomandimet.
Për vitin 2023 raporti i auditorit ka përmbajtje të pamodifikuar. Auditori pos opinionin ka theksuar bazën e opinionit, pajtueshmërisë, dhe ndikimit të çështjeve tjera të dokumenteve në raport. Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, 8 janë të reja, 6 të përsëritura, edhe pse është e pamundur që auditori të mbledhë të gjitha provat, dëshmitë e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të duhura për me mbështetur bazën e konkluzionit. Kolegu i jonë na tha me herët se nuk e kemi lexuar, po e lexojmë tani se çka ka thënë auditori. Të gjetjet, në 21, mostra të testuar, 19 raste në 273,647€, nuk janë respektuar hapat e procedimit të pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimit/furnizimet, pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhër blerja. Gjetjet tjetër, komuna me 31.12.2021 ka lidhë kontratë publike kornizë me çmim për njësi, të mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale, në vlerë 475,309.00€. Sipas raportit të menaxherit të kontratës, punë të kryera me kontratë ishin 504,309.00€, këtu kemi tejkalim të kontratës. Ky është keqpërdorim i buxhetit. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale, auditori nuk ka munduar me i marrë të gjitha mostrat me i audituar, nuk e di pse e ka bërë këtë lëshim, se në vitin 2023 nga mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtje të rrugëve lokale dhe rurale, ku janë shtruar asfalt, pikërisht rruga "Nazmi Osmani", këtë po e themi unë, ndërkaq nuk e di pse nuk e ka thënë auditori. Të projekti, rregullimi i Muzeut të Kaçanikut, në vlerë 61,999.00€, prokurimi kishte lëshuar dosjen e tenderit, duke specifikuar para-masën dhe para-llogarinë. Gjetje tjetër, në 3 raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhë kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv, të projektet: Ndërtimi i trotuarit , shtegut të çiklizmit dhe ndriçimit publik në rrugën "Murat Lika" Strazhë, Rregullimi dhe renovimi i infrastrukturës shëndetësore sociale, Rregullimi i muzeut në Kaçanik. Këto janë shkelje. Në procedurën e prokurimit "ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike" komuna kishte propozuar dhënie të kontratës operatorit ekonomik , i cili ishte vlerësuar si i papërgjegjshëm. Komuna kishte kërkuar nga operatori ekonomik dëshmitë(vërtetimin nga ATK dhe vërtetimin nga gjykata), për të përmbushur kërkesat e nënshkrimit të kontratës. Në QKMF gjatë vitit 2023 pa u bërë ndonjë analizë dhe një plan i mirëfilltë për nevoja të QKMF për punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës dhe pa marrë autorizim nga udhëheqësi me i lartë i institucionit, rregullisht gjatë fundjavës, kishte angazhuar një pjesë të stafit të punonte me orar 12 orësh, si punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, edhe pse ky angazhim i tyre nuk kishte të bëjë me raste të jashtëzakonshme apo me rritjen e vëllimit të punëve. Gjetja tjetër, nga testi i të hyrave, ka rezultuar se zyrtarët e komunës, paratë e mbledhura nga lëshimi i certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, kishin mbajtur nga 1 javë-6 muaj të pa dorëzuara tek arkëtari i komunës. Cila është llogaridhënia në këtë rast, që duhet me kërkuar nga zyrtarët përgjegjës. Gjetje tjetër, në 5 raste në vlerë 55,991.00€ është vërejtur se komuna nuk kishte kryer obligime financiare brenda afati prej 30 ditëve. Vonesat ishin 6 muaj nga data e pranimit të faturës. Dhe për atë në fund duhet të ndëshkohet, ashtu siç është ndëshkuar. Gjetje tjetër, komuna kishte bërë keq klasifikime të

shpenzimeve, duke paguar 65,128.00€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, të cilat për nga natyra ekonomike i takojnë investimeve kapitale. Gjetje tjetër, kemi vërejtur se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshtatshmërisë për fituesin e kontratës , siç janë: vërtetimi i ATK, vërtetimi nga gjykata, nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimi. Këto gjetje të auditorit, unë besoj se janë të mjaftueshme me kuptuar qytetarët sesi ka vepruar ekzekutivi i komunës. Këto rekomandime i dedikohen kryesisht kryetarit të komunës, besoj që kryetari i komunës nëse ka vullnetin dhe ndërgjegjen mundet t'i zbatoj, por çështja është paratë nuk mundet me t'i procedon në buxhet. Kjo është keqpërdorim i buxhetit, keqpërdorimi i parasë publike, kjo është shqetësim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti i auditorit është dokument që vjen për çdo vit për diskutim në KK për me pa se si ka paformuar komuna. Raporti bëhet nga auditori gjeneral i ZKA. Secili raport ka vërejtje, ne nuk mundemi me ndërhyrë në raportet e tij, se auditori është i pavarur. Për vitin 2023. Është një ndër raportet me të mira, në raport me komunat tjera dhe institucionet tjera relevante që auditohen në Kosovë, përfshirë ministritë etj. Ato gjetje që janë paraqitur, pajtohemi, por nuk janë gjetje të mëdha, se po të ishte ashtu qysh proklamohen, dikush shkon në përgjegjësi. Të gjeturat e auditorit dhe theksimi i çështjes, janë vepra penale dhe me to merret prokuroria. Auditor ka theksuar se të gjeturat janë shkelje të vogla që paraqitën në pasqyrat buxhetore financiare, në të cilat auditori është i thirrur t'i gjejë dhe t'i trajtoj dhe ne zotohemi se do ti zbatojmë ato rekomandime. Sa i përket këtij raporti, është një ndër raportet me të mira, që ka ardhur në komunën tonë, prej se unë jam këtu në KK, sepse për herë të parë është, "Raport me i pamodifikuar, pa theksim të çështjes", se kemi pasur raport para dy viteve që nuk kemi pasur mundësi as me aplikuar për grantin e përformancës. Raporti është shumë i mirë, nuk ka raport të auditimit që nuk ka gjetje, ky raport është me i mirë se ai i vitit të kaluar dhe me i mirë sesa raportet e viteve të tjera. Gjetjet e auditorit janë të vogla, opinionin e ka kualifikuar pa theksim të çështjes. Në gjetjet që i ka dhënë auditorit, me zbatimin e tyre merret ekzekutivit, për atë e bënë planin e veprimit sesi mendon me iu qasur të gjeturave në raport. Ne sa herë duhet të angazhohemi që raporti nga viti në vit çdo herë të jetë sa me i mirë, por të jeni të bindur se gjetjet e komunave tjera janë me të mëdha, por ne po flasim për gjetjet në raportin e komunës tonë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne po flasim për raportin e komunës tonë, pavarësisht opinioneve të raporteve të komunave tjera. Raporti është me i mirë në krahasim me vitet e kaluara, ka hapësirë për kritikë, se nga 14 gjetjet e auditorit, 8 janë gjetje të reja, 6 janë të përsëritura. Kërkoj që gjetjet e përsëritura të eliminohen. Është e qartë se gjetjet e reja, ka hapësirë me u përmirësua, kurse gjetjet e përsëritura, nëse auditori i ka gjetur ato gjetje, pse mos me u zbatuar e me i përsëritur nga viti në vit, se atëherë shtrohet pyetja, rekomandimet për zbatim pse po bëhen. Nuk është në rregull me u bërë edhe njëherë rekomandim për gjetjet e përsëritura.

**z. Selajdin Troni;** Sa i përket taksave të inkasuar nga certifikatat, që nuk janë dorëzuar me kohë, shuma e inkasuar është e vogël, ndoshta nuk ia vlen për ato mjete me ardhur në Kaçanik zyrtari.

**z. Agim Mani:** Unë e potencova çka ka thënë auditori. Auditori ka thënë se nuk janë dorëzuar te arkëtari i komunës inkasimet nga certifikatat e lindjes, ekstraktet, nga 1 javë-6 muaj. Gjashtë (6) muaj janë shumë, fjala vjen inkasimet të marrim shembull në Zyrën e vendit në Doganaj, mos me u dërguar të arkëtari në komunë.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Sa i përket mjeteve të mbledhura në Zyrat e vendit dhe dërgimi i tyre tek arkëtari në komunë, zakonisht kemi probleme, meqenëse puna në terren është me e pakët në sektorin e gjendjes civile, grumbullimi i mjeteve është i vogël, në krahasim me grumbullimin e mjeteve nga ofiqarët në komunë. Për këtë arsye, dërgimi i mjeteve nga zyrtarët është pak sa i vonuar në bazë të rregullores për dorëzimin e të hyrave. Unë në bashkëbisedim me auditorët, sigurisht se është problem nëse gjatë javës mblidhet një shumë e vogël dhe

detyrohet zyrtari me ardhur me i sjellë në komunë të arkëtari përgjegjës për grumbullimin e të hyrave, se kushton rruga, pastaj kushton edhe deponimi i atyre mjeteve në bankë. Nëse 2 certifikata nxirren brenda ditës, deponimi i tyre në bankë është 2€, fitimi është zero, pastaj pagesa e udhëtimit. Në bashkëpunim me drejtorin e financave mbajmë takime të rregullta, me mënjanuar këtë parregullsi, meqë është problem sigurimi i një saldoje të arkëtari, të personat që mbledhin mjete, se pala vjen me 50€ me nxjerrë certifikatën 1 €, duhet me pasur mjete me ia kthyer kusurin. Është problematike se auditorët nuk e shohin qysh funksionojnë arkëtarët, se i sigurojnë ata mjetet dhe cili është barazimi i tyre me arkëtarin përgjegjës. Në këtë drejtim, sa i përket mjeteve, ofiqarët e kanë obligim me i dorëzuar çdo cent, përndryshe munden me u paraqit problem të raporti financiar, me mbetur obligime zyrtarit dhe ne me marrë masa konkrete ndaj tij. Në këtë drejtim, jeni të qetë, ne jemi të barazuar me zyrtarët që punojnë në zyrat e vendit.
**z. Bashkim Luma**: Desha me theksuar të gjetjet në QKMF, ku janë punësuar 2 kryeinfermierë, ku është konfirmuar se njëri kishte ushtruar pozitën e depoistit, kjo nuk i bënë përshtypje aspak pozitës. Në anën tjetër, të çështja e vonesat në deponimin e parave nga zyrat e vendit në terren, nuk ka të bëjë me 1 javë apo 2 javë, por me 6 muaj, ndërkaq ofiqarët nga zyrat e vendit vijnë gati çdo javë në komunë, dhe ato mjete kanë mundur me i sjellë.

**z. Rrustem Zenuni:** Me vjen mirë që temë e diskutimit të raportit të auditorit janë 3€ certifikata. Gjatë tërë vitin ne duhet dëgjuar për devijim, tejkalim të buxhetit, duhet me pranuar faktin këtu se kur vjen raporti i auditorit, si rezultat i raportit ne kemi përfituar grantin e performancës 500,000.00€. Në qeverisjen tonë është bërë standard, është bërë praktikë që me ardhur raporte sa me të mira vit pas viti. Këtë duhet pranuar, duhet të jemi të kënaqur të gjithë që kemi arritur në këtë nivel, duhet pranuar që ky fakt është i vërtetë. Duhet t'i besojmë raportit të auditorit, pavarësisht opinionit, se ka që nuk i kanë besuar kur raporti ka dalë mirë. Raporti është i jashtëm, me qenë raporti jo në rregull, shkon në ministri të drejtësisë, ministria pastaj e dërgon në prokurori.
**znj. Ardita Rrahmani:** Në rast se është kështu si po e thotë kolegu, atëherë pse po e sjelli raportin e auditimit si pikë për diskutim. Nëse është me përmbushur një obligim ligjor, atëherë kolegu duhet me pranuar kritikat që vijnë nga zëri opozitarë. Tjera, nëse raporti krahasohet me ato të viteve me herët, është më i mirë, por nuk është në rregull që gjetjet me u përsëritur. Unë e kuptoj se qysh jeni institucionalist ju (Rrustem), ndoshta unë jam me shumë, pa modesti e themi këtë. Nuk mundesh me thënë se nuk iu dëgjon dikush, se duke me dëgjuar dikush, kam arritur këtu ku jam, kështu që tregoni respekt, pavarësisht kush është pozitë apo opozitë.

**z. Rrustem Zenuni:** Unë e pata për ndërhyrjen që ua bënë në vazhdimësi kolegëve këtu, nuk e pata për kritikat në raport për përsëritjen e rekomandimeve. Unë thashë: Ndërhyrja e juaj në diskutime nuk është e drejtë, se nuk është etike me ndërpre dike kur diskuton.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Me herët në këtë mbledhje u tha se po diskutohet pa rend, si në ditë të grave. Kisha kërkuar mos të bëhen bulëzime në aspektin gjinor, sepse nëse dikush i sheh gratë si numra, ne i shohim si vlera, se ne jemi vlerë e shoqërisë. Janë dhënë 14 rekomandime të auditorit, 6 prej rekomandimeve janë të përsëritura. Unë nuk e shoh se është në rregull 6 rekomandime me u përsëritur. Uroj që këto rekomandime të marrin fund, të ecim përpara duke respektuar ligjin dhe rregullat. Desha me pyetur drejtorin e Shëndetësisë, për festat zyrtare, kujdestaritë në QKMF: A iu paguhet orët të dielën, ndërrimi i natës të dielën që është festë, në rast kur të hënën nuk punohet për shkak të festës?

**Kryetari i Komunës:** Po me vjen mirë që po i kritikon të tjerët për bulëzim, megjithatë është mirë me qenë vet kritikues. Një ndër ata që nganjëherë kritikoni, jeni ju, me quani mua të paditur. Këto nuk janë fjalë të mira, se ka fjalë me të kulturuara, sikurse ti që nuk po e pranon një kritikë. Të raporti i auditimit, me vjen mirë që kritikoni, se për atë jemi ne këtu. Nëse e keni

vërejtur, në fillim shënohet, opinioni i pamodifikuar pa theksim të çështjes. Raporti është i mirë në këtë vit dhe vitin e kaluar, se vitet tjera ka qenë me theksim të çështjes. Çështja e përsëritjes se të gjeturave, munden me u përsëritur, se disa nuk kanë mundësi me u zbatuar, si çështja e pagesave, nuk kemi mundësi pa aneks kontrata, se nganjëherë na e imponojnë rrethanat. Edhe për një kohë, jo që nuk dua, por janë do rekomandime që nuk mundemi me i rregulluar menjëherë, pagesat janë rregulluar menjëherë, çështja e kryeinfermierit është rregulluar, por janë do që edhe ju me qenë e keni të pamundur me i arritur, por nuk janë shkelje që ndikojnë në opinion, gjë që kjo me ka bërë të ndiej vetën mirë. Kemi gabime e të meta, por çdo herë shpresojmë duke na kritikuar ju, ti eliminojmë ato të meta, por jemi edhe për lëvdata, ku është çështja e shpenzimit të buxhetit 2023, por atë nuk na thoni asnjëherë. Ju keni obligim ndaj qytetarëve edhe me ndihmuar kryetarin, jo vetëm, me kritikuar, se kjo iu bënë nderë, e jo vetëm me qenë kritikues.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Me pyetje dhe kërkesa, ne jemi munduar me iu ndihmuar, ndërkaq ekzekutivin e keni emëruar ju, andaj kërkoni llogari prej tyre.

**Kryetari i Komunës:** Nuk me kuptove Kadrije. Ne kemi nevojë me na ndihmuar edhe në forma tjera. Aty ku ka mundësi me ndihmuar, qoftë pozitë apo opozitë, për interes të qytetarëve, edhe juve iu faturohet ai sukses, jo vetëm kryetarit. Aty ku keni ndikimin, aty ku keni mundësi me ndihmuar, kërkoj të na ndihmoni, se juve iu faturohet diçka që keni mundësi me bërë për në interes të qytetarëve të Kaçanikut. Mirë që na kritikoni, kur jemi për kritika, por edhe aty ku keni mundësi me na ndihmuar, na ndihmoni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti ishte sa për njoftim. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**NJOFTOHET**

**Me Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023/Lënda: 01Nr. 104/02-16337/24.**

**4.** Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Duke marrë parasysh se rekomandimet nuk janë zbatuar në vitin e kaluar, janë përsëritur, kemi arsye të dyshojmë se planifikimi dhe angazhimi aktual për zbatimin e këtyre rekomandimeve, nuk është i mjaftueshëm për me u realizuar një zbatim i suksesshëm. Vetëm planifikimi pa veprim konkret, rezultatet shihen se nuk janë të mjaftueshme për me na bindur neve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalime politike sa të dush, keni në dorë sa të duash, e keni krejt qeverinë në nivel qendror, se theksove se nuk kam asgjë në dorë me na ndihmuar.

**Kryetari i Komunës:** U bënë 4 vjet dhe nuk kemi asnjë investime në projekte nga ministria. Një shkresë ia dërgova Arditës sesa kemi pasur kërkesa në ministri për projekte dhe sa është investuar. Kërkesa ka qenë për 5 projekte, asnjë përgjigje nuk e kemi. Janë nënshkruar 49 marrëveshje në nivel të Kosovës, e kemi edhe zëvendësministrin aty nga Kaçaniku, nuk kemi asnjë realizim. Kërkesa për projekte është me numër të protokollit, përgjigje nuk kemi.

**z. Agim Mani:** Kemi projekte që janë bashkë- financuar, si Objekti i banimit social, Fusha e sporteve, etj., ku janë këto projekte?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Se qysh kemi për-formuar si komunë, është raporti i auditorit që e paraqet gjendjen.
**z. Rrustem Zenuni:** Në ministri është edhe Projekti për ndërtimin dhe rregullimin e terreneve sportive në f. Duraj. Projekti është i mirë, kështu që ndihmoni procesin që të kalon ky projekt.
**z. Agim Mani:** Rrustem, e paske gabuar adresën, adresa është diku tjetër, jo këtu, adresa ka emër.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Plani i veprimit është sa për njoftim. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**NJOFTOHET**

**Me Planin e Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023/ Lënda: 01Nr. 104/02-16344/24.**

**5.** Propozim Vendim për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Unë edhe në mbledhjen e KPF e diskutova se kemi të bëjmë me 2 kërkesa të cilat na kanë ardhur si pako, njëra e vitit 2021 dhe tjetra e vitit 2024 e këtij muaji. Pyetje për drejtorin: A kemi kërkesa ndërmjet këtyre, të cilat janë në pritje, pasi e shohim si konflikt interesi që një kërkesë me ardhur brenda muaji, dhe i përket zyrtarit që punon në komunë? Asgjë personale me zyrtarin nuk kam, mirëpo për ata kërkesa që presin në radhë, a kanë ndonjë përgjigje se kur iu vjen radha?

**z. Agim Mani:** Është mirë të sqarohet, sa kërkesa janë nga viti 2022 deri me qershor 2024 të pashqyrtuara? Sepse, është marrë në shqyrtim një e vitit 2021 dhe një e vitit 2024. Në mes këtyre kërkesave, a ka kërkesa tjera? Kërkesat është dashur të vijnë ndaras. Ligji thotë, për shpallje interes publik apo këmbim prone, fillimisht duhet me pasur projektin për atë pronë, buxhetin e ndarë, pastaj me u bërë shpronësimi. A keni ndarë buxhet për këtë shpronësim, cili është projekti?
**z. Rrustem Zenuni:** Ne, vet kemi kërkuar që çështjet e natyrës së njëjtë t 'na vijnë me një pikë, se u patëm lodhë ka 4-5 pikë të veçanta, kështu që në rregull është drejtor, vazhdoni kështu me sjellë lëndë për shpronësim.
**z. Selajdin Troni**: Drejtori edhe pse i ka sjellë me një pikë, ka dhënë vlerësimin për secilën pronë, se janë për zgjerim të rrugëve. Besoj se na ndihmoni në këtë drejtim ju si opozitë, se nuk po na ndihmoni fare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo pikë është trajtuar edhe në KPF, nuk është në rregull me i trajtuar si kërkesa të qytetarëve, se aty ku është interesi i institucionit, ato prona trajtohen si interes i komunës, që mendon se duhet me shpallë me interes publik. Komuna i cakton zonat me interes publik. Mundet me pasur kërkesa për me shpallë interes publik një pronë, por që komuna nuk e sheh atë pronë me interes publik, dhe ajo kërkesë mundet mos me u shqyrtuar fare. Ka kërkesa që janë me interes publik, dhe zhvillohet procedura. Ka raste kur prona këmbehet dhe nuk ka nevojë për buxhet. Pronat me interes publik i dimë për çka bëhen, për ndërtimin e një shkolle, ambulance, zgjerim rruge dhe të ngjashme. Çdo kërkesë që vjen me shpallë me interes publik, komuna nuk mundet të trajtoj me interes, nëse nuk e ka interesin publik komuna. Kërkesat duhet të trajtohen si kërkesa të drejtorisë së Urbanizmit, për me shpallë një pronë me interes publik.
**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në KPF e ceka se lagjja ku unë banoj, e kemi adresuar një kërkesë në muajin maj. Pronarët, pronën e tyre private ia japin komunës, vetëm me ua shtruar asfaltin. Pyetje për drejtorin e DUKMM, Qamil Stagova: A është ajo kërkesë me interes publik? Këtë pyetje e bëjë, pasi drejtoria nuk ka formuar as komision me dalë në vendngjarje, se a i plotëson

kriteret ajo pronë me u shpallë me interes publik. Ajo pronë, përveç se ua rregullon rrugën banorëve të komunitetit, është me interes publik, se prona po i kalon komunës. Për derisa kërkesat e adresuara me herët nuk merren parasysh, ndërsa një kërkesë që e potencova edhe me herët e këtij muaji, merret parasysh, asgjë personale me zyrtarin në fjalë, po e potencoj edhe njëherë, çka me iu thënë banorëve të lagjes, çka me iu thënë diasporës se asaj lagjeje, kur dikujt i aprovohet kërkesa menjëherë, ndërkaq ajo kërkesë ende nuk është marrë në shqyrtim?

**z. Qamil Stagova:** Kemi kërkesa të njëjtës natyrë sikurse këto dyja. Për tjerat, ajo është për asfaltim të rrugës. Para zgjedhjeve, ka kaluar prej KK, ministria nuk e ka aprovuar ligjshmërinë për shkak të zgjedhjeve, tani ajo kërkesë është bërë përsëri.

**z. Selajdin Troni:** Kërkesa nuk është puna se është e zyrtarit të komunës, por ajo pronë është me interes publik, sepse po duam me drejtuar rrugën. Në këtë rast, të kjo kërkesë jemi duke bërë këmbimin e pronave, për rregullimin e rrugës.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Mirë që e sqarove. Unë e pyetja drejtorin: A është interes publik kërkesa e komunitetit, që po japin pronën për rrugë?

**z. Selajdin Troni:** Patjetër, ajo pronë është me interes publik.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër 5 votë, Abstenim nuk ka. Prezent 23. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

**VENDIM**

**Për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec/ Lënda: 01Nr. 104/02-16985/24.**

**6.** Informatë rreth gjendjes aktuale të furnizimit me ujë në komunën e Kaçanikut dhe shfrytëzimi i aseteve të financuara nga buxheti komunal dhe donatorët për nevojat e rrjeteve të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU ”Bifurkacioni”-Njësia e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo pikë ka rrjedhë si kërkesë nga mbledhja e kaluar, për shkak të gjendjes se krijuar të ujit të pijes në komunën tonë. Me kërkesë iu kemi drejtuar edhe KRU ”Bifurkacioni” në Ferizaj me marrë pjesë në këtë mbledhje, nuk ka ardhur, i paska dhënë do arsye. Drejtori i DSHPE është këtu. Gjendja e ujit të pijes nuk është e mirë. Debatin mund të zhvillojnë edhe në mungesë të tyre. E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Ai që ballafaqohet me mungesën e ujit, e dinë sa e vështirë është me përballuar gjendjen në pikun e verës. Unë besoj se edhe në sezonin e dimrit mund të jetë kjo gjendje, por po flas për këtë sezonë, ku edhe mërgimtarët janë këtu. Nuk është viti i parë që ballafaqohemi me këtë problem, shpresoj të jetë i fundit, ndërkaq është mungesa e njerëzve kompetent me dhënë përgjigje, pse po përballemi me mungesën e ujit të pijes. Kushdo që merret me këtë problem, të vënë gishtin në kokë dhe të mendon se çka kemi me iu bërë këtyre njerëzve. Heshtja flet vet. Edhe vet ballafaqohem me këtë problem, ndërkaq kam thirrje të shumta prej qytetarëve që përballën me mungesën e ujit të pijes. Thirrja për informatë, ka rrjedhë nga kolegu që nuk qenka këtu. Për dallim prej disave që kur u diskutua kjo pikë, e kanë lëshuar mbledhjen, unë po qëndroj këtu dhe do të qëndroj çdo herë kur diskutohet kjo çështje. Drejtori i kishe përcjellë shkresat, faleminderit shumë. Kishte me qenë mirë me pasur përgjigje, unë nuk dal nga mbledhja pa përgjigje, se atyre njerëzve që po na përcjellin nuk e di çka iu themi. Po me vjen keç edhe në shëtitore me dalë, ani pse unë jam opozitë ata po kërkojnë me ditur çka u bë me ujin e pijes. Është e turpshme për secilin situata që jemi ardhur, bashkë ndjej me secilin mërgimtarë dhe me secilin qytetarë, pavarësisht mungesës se ujit, ata rrinë këtu.

**z. Rrustem Zenuni:** Ne e kemi pa gjendjen e ujit në bazë të materialit që na është ofruar, ata që është dashur me ardhur sot këtu, nuk kanë ardhur. Ne nuk kemi autorizime ligjore me u kujdesur që qytetari me pasur ujë. Është kompania KRU "Bifurkacioni" e cila e ka edhe investimin e komunës dhe nuk ka bërë asgjë. Është mirë që ka ardhur rasti me pa edhe përgjegjësinë, ndërkaq duhet gjetur edhe forma tjera kundër atyre që i mbajnë produktet dhe pozitat për veti, ndërkaq qytetarin e lënë aty ku nuk duhet me lënë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju lus që gjatë diskutimeve, t'i përmbahemi gjuhës, të përmbaheni nga aspekti i ofendimeve se nuk është mirë, megjithëse ajo është përgjegjësi e secilit se është gjuhë publike. Ky është institucion, gjuha këtu ka etikë, kështu përmbajuni.

**z. Agim Mani:** Ujë ka Kaçaniku, por menaxhim nuk ka. Burimet e ujit janë nga të gjitha anët, ka investime, por mungesë të përgjegjësisë në projektet që janë realizuar, se ka defekte në projektet e realizimit të ujit. Nuk ka mbikëqyrje të projekteve të cilat realizohen. Pyetje për Rrustemin: A paguani për ujin?

**z. Rrustem Zenuni:** Jo, nuk marrë ujë në pronë publike.

**z. Agim Mani:** Unë mendoj se problemi është të pagesat e ujit. Ekzekutivi i komunës, Drejtori i DSHPE nuk e ka marrë seriozisht këtë çështje asnjëherë. Projekti ka qenë: 1 milion e 200 mijë euro për ujësjellësin e Kaçanikut. Me këtë projekt, komuna është dashur me zgjidhur problemin e ujësjellësit në tërësi, por menaxherë të projekteve me i përcjellë realizimin e punimeve nuk ka pasur. Thuhet se ky projekt është nga viti 2020-2024 janë dhënë statistikat për këtë projekt. Mendoj se ky projekt ka qenë me herët, nga vitet: 2017-2018.

**z. Ramadush Osmani:** Në vitin 2020, është përfunduar ky projekt dhe është dorëzuar si aset.

**z. Agim Mani:** A e dini ju se me këtë projekt, ka rezervuare që janë pa ujë. Mungesa e ujit që ballafaqohen qytetarët e komunës së Kaçanikut, është neglizhenca e juaj, se kur vjen puna për raport, thoni se i gjithë territori i komunës së Kaçanikut ka mbulueshmëri me ujë të pijes, ndërkaq në anën tjetër, nëse e shikojmë gjendjen aktuale, ka mungesë të madhe të ujit të pijes. A ka mbulueshmeri me ujë i tërë territori i komunës së Kaçanikut, apo nuk ka?

**z. Bashkim Krasniqi**: Problematika e ujit është të krejt e njëjtë, ndërsa po flas për Kaçanik të Vjetër, nuk pajtohem këtu me Agimin, komuna e ka hapur një pus, ujë ka, menaxhim nuk ka. Që tre muaj është porositur një pompë, por nuk na ka ardhur, kështu për një pompë Kaçaniku i Vjetër dhe Begraca janë pa ujë. Çështja se a paguhet uji apo jo, ajo është e çështje private e secilit, se qysh i mbledhin mjetet, ajo është çështje e kompanisë. Mos ia hidhni fajin komunës, drejtorit, se komuna ka hapur pusin, janë 2 puse që nuk shfrytëzohen, njëri në Koxhaj, tjetri në afërsi të"Ballkan Petroli", por çështja është e menaxhimit. Pse nuk e pranoni, pse mundohesh me ua hedhur fajin dikujt tjetër? Ujë ka, por nuk ka menaxhim.

**znj. Ardita Rrahmani:** Personat përgjegjës për menaxhimin e ujit, kujt i japin llogari?

**z. Selajdin Troni:** Nuk e di sa ka kompetencë drejtori sa i përket menaxhimit të ujit të pijes. E kam një shqetësim për një gyp të ujit në f. Kovaçec, i cili gyp nuk ka ujë, ndërkaq ky komunitet ka mungesë të ujit 60-70% e komunitetit kanë ankesa, se janë pa ujë në mungesë të funksionalizimit të atij gypi të ujit. Të pjesa tjetër e menaxhimit, na sqaron drejtori, çështja është, me u zgjidhur problemi, ndërsa nuk është me rëndësi në kompetenca të kujt është.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sa i përket problematikës së ujit, edhe në pjesë Nikë, Soponicë-Doganaj, përballën me problemin e ujit të pijes si gjithë qytetarët në Kaçanik. Problemet janë të natyrave të ndryshme, disa me sasinë e ujit, disa me defekteve teknike të rrjetit, dhe në fund tek të gjithë mungon uji. Për pjesën: Nikë-Rekë-Soponicë-Doganaj –Elezaj, në vitin 2015 është bërë një projekt që ka përfshirë 65 mijë metra gjatësi, është financuar nga banorët, projekti u realizuar nga një kompani e Ferizajt “Hidroprojekti”, 60,000€ ka kushtuar projekti, komuna ka financuar 20,000€, pjesa tjetër nga banorët, për me na i financuar projektin ministria e mjedisit, ministër apo zëvendës ministër ka qenë atëherë Ferat Shala, për të cilin projekt komuna ka pasur shumë nevojë, sidomos fshatrat Elezaj, Koxhaj. Banorët e komuniteteve qysh herët janë organizuar me mjetet e veta me sjellë ujin e pijes, Doganaj, Elezaj, Dubravë. Prej atëherë edhe në vitet 90 –ta në kohën e okupimit, komunitet janë organizuar me sjellë burime të reja të ujit. Në vitin 2015 është bërë investime në shtimin e kapacitetit të ujit, ndërrimin e gypit të ujit. Krejt këto pune, angazhime, vullnet i qytetarëve, në fund me një marrëveshje iu ka dërguar KRU “Bifurkacionit” për me menaxhuar me ujin. U tha se ka burime pa ujë, përpara nuk ka pasur, ne nuk mundemi me siguruar jetëgjatësinë e një burimi, tani mund të ketë, burime të ujit ka në rrjet, menaxhimi nuk është i mirë, ndarja është profesionale, por menaxhimi nuk është si duhet. Nisur nga kjo, duke pa marrëveshjet që janë bërë, kërkesat e qytetarëve për ujë, krejt ky komunitet është në prag të shkëputjes se asaj marrëveshje, sepse krejt janë të mendimit se ma shumë ujë kanë pasur kur e kanë menaxhuar ujin vet në mënyrë vullnetare sesa sot. Për atë jemi dëshmitarë edhe vet, kanë thënë se rritë shpenzimet, nuk po kemi llogari se është zvogëluar popullsia. Për atë kemi dashur që të jetë dikush nga njerëzit kompetentë këtu, me i trajtuar këto probleme. Sido që të jetë, para se me ardhur deri të akti që e potencova, i cili ka me ndodhë se shpejti, prapë kam insistua që nëse ata nuk vijnë këtu, shkojmë ne nga secili grup parlamentar nga 1 ose 2, për me zgjidhur këtë çështje, se njerëzit janë duke u përballë me mungesën e ujit të pijes. Ne nuk po largohemi nga përgjegjësi, por nuk po kemi mundësi me ekzekutuar, por me kërkuar prej atyre që janë përgjegjës, për me zgjidhur këtë problem. Këto investime që janë bërë, po flas për pjesën nga vijë e që kam njohuri, nuk lejon askush që ai mund e sakrificë, me shkuar huq dhe me mbetur pa ujë. Këtë lë ta dinë ata, edhe komuna edhe pse nuk është përgjegjëse, se ai ujë nuk ka me u menaxhuar më ashtu, ka me u menaxhuar qoftë edhe në formë vullnetare, por jo më me njerëz të papërgjegjshëm. Faturat vijnë enorme, pa shikuar fare orët matëse. Kjo është e çuditshme, duhet kërkojmë llogari tek personat përgjegjës. Ne kemi pasur raste kur kemi bërë shkëputje të aksioneve prej kompanive regjionale. E di se nuk është me ligj, por kur është në pyetje, çështjet elementare për jetesë, nuk duhet shikuar as ligjin. Na tani me u marrë me lloj njerëz se jam apo nuk jam kompetent, nuk kam obligim me iu raportuar juve, e në anën tjetër njerëzit nuk kanë ujë, këto janë kopalla. Duhet me dhënë llogari para KK për gjendjen e ujit dhe pse ka ardhur kjo gjendje, gjithsecili, unë si kryesues, kryetari, drejtori, kryeshefi, pse njerëzit sot ende dalin me rregulluar kanalin e ujit, se nuk shkon kush me rregulluar, kjo është e turpshme. Sot të vjen fatura me paguar ujin, ndërkaq, ndërsa qytetari detyrohet vet me hap kanalin e ujit, kjo nuk është në rregull. Kjo gjendje nuk duhet me vazhduar tutje.
**z. Ramadush Osmani:** Pika që është kërkuar për diskutim, jam munduar me qenë shumë transparent, me informua se pari qytetarin edhe juve si anëtarë të zgjedhur me votën e qytetarëve. Me vjen mirë që Ardita e paska lexuar bukur mirë, jam munduar me i përcjellë edhe kontaktet zyrtare me menaxhmerntin udhëheqës të KRU ”Bifurkacioni”. Si drejtor i DSHPE, për punët që bien në domenin e kësaj drejtorie, janë tri kompani, janë stacioni i autobusëve 100% me aksione, 14% aksione me Pastërtia dhe Kompania KRU ”Bifurkacioni” që aksionet e komunës nuk ekzistojnë, ndërmarrja ka kaluar në nivel qendror. Vendimin jemi detyruar me marrë në KK, me vendim të kryeministrit që me kaluar ndërmarrja në nivel qendror. Me dy të parat jemi të kënaqur, ndërkaq të tri ndërmarrjet kemi investuar. Në Pastërtia kemi investuar makineri të re, e cila është futur në funksion, dhe kemi arritur edhe financiarisht të shfrytëzojmë ligjin që të kemi njësinë operative funksionale dhe është duke funksionuar jashtëzakonisht mirë dhe është duke i shfrytëzuar asetet që iu kanë dhënë si aksionar dhe donatorët ose përmes

performancës tonë si komunë, nga granti i performancës si mjedis i pastër, ku kemi përfituar si komunë. Që nga ardhja ime nga viti 2015, kam shprehë shqetësimet e mija për KRU" "Bifurkacionin" se nuk po funksionon në aspektin menaxherie. Njësia e Kaçanikut gjithmonë ka qenë një njësi e neglizhuar nga qendra, ose të paktën e ka luajtur një rol për viktimizim, duke mos qenë aktive si njësi për ta mbrojtur asetin. Ju kam ofruar të dhëna për investime që iu kanë dorëzuar kësaj kompanie.

**z. Kadri Krivenjeva:** Agimi nuk qëndroj me marrë përgjigjen, doli nga mbledhja.

**z. Ramadush Osmani:** Agimi u largua mos me marrë përgjigjen, nuk ka problem, mbledhja është duke u incizuar. Gjysmë milioni euro janë dhënë nga buxheti për rrjetin e ujësjellësit në bashkërendim me konfiguracionin. Para se me i caktuar prioritete, ne i kemi bashkërenduar aktivitetet se për çka kanë nevojë, se është kompani e licencuar nga ARU për me i kryer shërbimet në menaxhim të ujit dhe ujërat e ndotura. Po e themi me shumë përgjegjësi, ne kemi menduar si komunë edhe për muajin e pikut, sepse në muajit kur nuk ka të reshura nuk ka telashe, por ne kemi menduar për muajt e pikut, sisteme alternative. Të fabrika e gëlqeres ekziston pusi i gatshëm, i dezinfektuar se i keni marrë edhe raportet e ujit që është i përdorshëm. Ekziston pompa të cilën vetëm me sustë mbushet rrjeti i ujësjellësit të Kaçanikut. Nuk e bëjnë këtë, nuk e di këtë, ndërkaq komuna ka investuar njëherë rrjetin, herën e dytë e kemi lyer, kemi vendosur pllaka dhe e kemi pastruar pusin dhe i kemi marrë mostrat dhe ia kemi dërguar kompanisë, se mundet me thënë ndokund se uji nuk është i pijshëm. Rasti tjetër, për sistemin e rrjetit të ujësjellësit në Doganaj dhe Elezaj, kemi hapur puse 120 metra, odën akumuluese, kemi vendosur pompën që në muajit e pikut të shtohet uji në mënyrë alternative, jo gjithmonë, vetëm kur të ketë nevojë me përdorë, por nuk e futë në sistem. I kemi thënë se është shtuar numri i banorëve në Kaçanik të Vjetër dhe Begracë, kemi kërkuar nga njësia operative se çka me bërë. Na kanë thënë: Mjafton a po na e hapni edhe një pus, se dy puset nuk mjaftojnë, zgjidhet problemi, ua kemi hapur pusin. Sot pusi është i lidhur në sistem të stacionit të pompimit. Nuk është funksional, sepse i kalkulojnë aspektet tjera, si të shpenzimit të pompave, procedurat e prokurimit në rast se pompat djegën e kështu me radhë. Është shqetësim çështja e aseteve që po investon komuna, nuk po i fusin në funksion, të cilat sot do të zgjidhnin problemin e ujit të Kaçanikut. 10 litra në sekondë sjellë pompa nga pusi i gëlqeres, diku 12-13 litra në sekondë mund të dërgohen tek rezervari i 7 fshatrave. Sot kam mungesë të ujit edhe në fshatin tim.
Mbulueshmeria e sistemit të ujësjellësit në Kaçanikut, është 98%, disa janë në menaxhim të komuniteteve. Unë e arsyetoj mbulueshmërinë me rrjet. Fshatrat: Duraj, Semajë, Gabricë, Prushaj, kanë rrjet të ujësjellësit, por e menaxhojnë vet, deri sa t'i vjen momenti të futen në menaxhim, se nuk do të lejohet menaxhim privat i rrjeteve të ujësjellësit. Me këtë përformancë edhe unë jam skeptik, pse me ia dhënë një aset që as nuk e shfrytëzon edhe i dëmton. Kemi pompa të djegura të cilat janë dorëzuar, të cilat nuk janë riparuar. Këtë shqetësim të dëgjon qytetari, sepse unë kam komunikime zyrtare të cilat nuk i përgjigjën. Kërkoj zyrtarisht me u aktivizuar pompa e Kaçanikut se ka nevojë për ujë, nuk e aktivizon, ia heq dyshimet se uji nuk është i kontaminuar, edhe pse KRU" Bifurkacioni" ka për obligim ligjor se ka licencë prej ARU, me marrë masa periodike, dhe me na njoftuar për rritjen e fenomeneve të ndryshme. KRU "Bifurkacioni" ka kaluar si ndërmarrje në nivel qendror, Bordi i drejtorëve zgjidhet nga qeveria. Në këtë rast aksionet e komunës nuk ekzistojnë, janë aksione në qeveri. Ky kalim nga niveli regjional në nivel ministror i kompanisë, është bërë për me thithur investime. Paramendoni a ka thithur investime Bifurkacioni, pos një gjysmë milioni, që me tepër është bërë propagandë nga kompania në raport me ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, duke i proklamuar nja 20 milion që po investon nëpër ujë të Kosovës, a në fakt vetëm gjysmë milioni është ndal në Ferizaj për shtimin e kapacitetit të stacionit të pompimit-fabrikës së ujit në Ferizaj. Rrjeti i ujësjellësit i pjesës së Dubravës është dorëzuar me marrëveshje të komunitetit dhe është pranuar edhe pas një rishikimi në terren që e kam bërë në terren me punëtorët e tyre. Ne nuk

do të ndalemi këtu, ne mendojmë si komunë që problematika e ujësjellësit gjithmonë do të jetë pikë diskutimi. Ju e keni votuar buxhetin, ne e kemi paraparë si zgjidhje afatgjate: Ndërtimin e një fabrike me kuotën me të lartë të rajonit që e mbulon. Me ndërtimin e asaj fabrike, ne mund të sjellim sasi të ujit mbitokësor, i cili do të përpunohet në rrjetin ekzistues. E kemi sistemin e gatshëm, projektin e kemi dorëzuar në Bifurkacion, na i kanë kërkuar me futur si njësi, nuk e kanë realizuar. Kemi me shqyrtuar mundësinë që në vitet e ardhme me mundësitë tona buxhetore, 1 -1.5 milion të ndërtojmë këtë projekt, me zgjidhë këtë problem, pastaj me aktivizimin e saj do ti eliminojmë pompat në Kaçanik të vjetër, Begracë, Stagovë, dhe do ta mbulojmë atë sistem me rënie të lirë. Për Kovaçec, nga mjetet buxhetore të komunës është furnizuar gypi, i kemi kërkuar KRU"Bifurkacioni" për kyçje, se është përgjegjës, nuk e ka realizuar. Asetin ua kemi ofruar, por nuk e fusin në sistem.

**z. Rrustem Zenuni:** Ne duhet me dalë me një shkresë me i njoftuar qytetarët se komuna nuk ka kompetencë për menaxhimin e ujit të pijes, se shumë kush mendojnë se adresa është në komunë, i kemi parë edhe portalet që dalin e flasin, është mirë me sqaruar këtë çështje, se ne po na bëhet edhe presion politik. Unë propozoj që ne si shoqëri, me marrë edhe veprime tjera, me organizuar protesta para KRU "Bifurkacioni", për shkak se dikush duhet me dalë me sqaruar aty, pse është kjo gjendje e ujit të pijes, me sqaruar problemin për secilin se ku ka gabuar, se ka njerëz që 24 orë bëjnë propagandë, ku i shfrytëzojnë edhe ceremonitë mortore dhe ato të dasmave me na fajësuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë ata të kompanisë nuk janë këtu dhe nuk vijnë, propozoj nga subjektet e grupeve parlamentare të formojmë një ekip dhe të shkojmë të KRU "Bifurkacioni". Këtë çështje duhet trajtuar me urgjencë, për shkak se gjendja nuk është e mirë. Në takime që kam marrë pjesë në kolegjiume dhe organizata të ndryshme, kur trajtohet çështja e ujit dhe kanalizimeve, ata na thonë që krejt investimet që i bënë komuna në këto projekte, janë të kundërligjshme, sepse jeni duke investuar në pronë të huaj. Me ligj është ashtu, se investimet duhet me i bërë KRU "Bifurkacioni" dhe na tërheqin vërejtjen se në të ardhmen mundemi me u akuzuar për këto çështje, sepse nuk janë asete të huaja, e jo të juaja. Ne nuk i kemi shikuar këto çështje, e kemi shikuar që është çështje elementare njerëzit me pasur ujë. Është mirë me u formuar një ekipe qoftë nga shefat e grupeve apo me anëtarë të KK nga regjionet që janë, me mbajtur një takim me KRU "Bifurkacioni', sepse unë po flas për banorët nga ana ime, ata janë shumë të revoltuar, bile na akuzojnë se ne kemi lidhur marrëveshje me KRU "Bifurkacioni" që ata me menaxhuar ujin e pijes.

**z. Selajdin Troni:** Unë nuk kisha thënë me qenë çështje politike uji, ne nuk na intereson kush qysh e menaxhon ujin, ne na intereson me pasur ujë. Është një bord i kompanisë dhe ata duhet me i ftuar këtu në një takim. Unë personalisht nuk kam ujë të pijes, uji është deri të shatki që tre vjet, ndërsa ujë nuk kam. Qysh bëhet tërë ai investim, ku banorët kanë investuar me mijëra euro, ndërsa ujin po ia bëjnë me pagesë, kjo është një papërgjegjësi. Ju investoni sa të doni, unë mundem me të dërguar në përmbarues, në gjyq. Kjo është e padrejtë. Shumica e kanë ujin privat në fshatin tim me mjete vetanake, kanë investuar me mijëra euro, ndërkaq uji iu bëhet me pagesë. Për çështjen e ujit të pijes, jam për me organizuar protestë të madhe para zyrave të KRU "Bifurkacioni", para atyre që neglizhojnë e nuk punojnë, kushdo që është atje.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kushdo që është atje, në momentin që merret përgjegjësia, qoftë përmes emërimit apo formave tjera, llogaridhënia duhet me ekzistuar, se ia kanë obligim secilit qytetarë, pavarësisht subjektit politik. Neve nuk kemi ujë në shtëpi, e këtu vijmë bëjmë politikë, kjo nuk është në rregull. A e dini që ka fëmijë që kanë lindur në muajin paraprak, dhe nënat e tyre nuk kanë ujë me i pastruar fëmijët e tyre, detyrohen me gjetur forma se ku me pastruar bebën. A ka kush ndërgjegje në këtë vend, po e lëmë anën politike, e më shikuar çështjen e atyre njerëzve që janë pa ujë. Duhet me thirrur ndërgjegjes, pak, e turpshëm. Të prindërit e mi, që 1 muaj e gjysmë janë pa ujë, aq me tepër edhe me rastin e gjyshes në karrocë. Nuk po e

personalizoj, se ka edhe raste tjera, kjo thirrje për me shkuar në zyrat e KRU “Bifurkacioni”, duhet me qenë imediate dhe brenda kësaj jave. Nuk kemi nevojë me pritur për javën tjetër, se ata e kanë një orar nga 8-16 me qëndruar në zyre. Sot mundemi me ua dërguar një email, nesër apo pasnesër me iu shkuar në zyre, lë të na kthejnë, nuk mërzitëm pse na kthejnë, por nesër pasnesër mund me kaluar në një ekstrem tjetër, protestë. Nuk është në natyrën time kjo, se fuqia ime është fjala këtu. Përmes kësaj foltoreje këtu, po kërkoj t’i thirremi ndërgjegjes.

**Nënkryetari i Komunës:** Po e ndiej obligim me i thënë disa fjalë, edhe pse drejtori e elaboroj në mënyrë të shkëlqyer. Shqetësimi i juaj është me vend, duhet me dhënë angazhimin tonë maksimal me zgjidhur këtë çështje, pavarësisht a kemi kompetencë apo jo. Para se me ardhur në KK, Kryeshefi i kompanisë me shkruaji se nuk kemi të drejtë ligjore me ardhur e me raportuar në KK. Nuk është që nuk shprehin gatishmëri me u takuar këtu, ne se bashku me drejtorin jemi takuar shpesh të KRU ”Bifurkacioni”, kemi shprehë gatishmëri për ndërtimin e një fabrike të ujit, por që 2 vite nuk ka diçka në këtë drejtim. ai na ka njoftuar se janë dy gypa $100 që veç me shtypë sustën, ka ujë sa të doni, por nuk po na lejojnë me marrë ujë në mënyrë sipërfaqësore. Kam kërkuar takim urgjent me administratorët e 7 fshatrave, e kemi thirrur edhe kryeshefin e kompanisë, dhe u.d. këtu që ka qenë, dhe i kemi thënë kryeshefit se kujt me iu drejtuar qytetarët e komunës. Sipas kryeshefit, duhet me iu drejtuar KRU ”Bifurkacioni” që është kompani e licencuat me menaxhuar ujërat. Edhe ai e pranon se nuk po munden me menaxhuar si duhet. Ndërkaq nevojë imediate është; Shefat e GP, Drejtori, kryesuesi, me ia shkruar një email menjëherë. Ai tha se nuk ka të drejtë ligjore me raportuar në KK, nuk e di pse nuk ka të drejtë. Që një muaj është u.d,., por kushdo që është aty, është nevojë imediate me u takuar. Sipas kryeshefit të KRU ”Bifurkacioni” e kemi edhe në procesverbal, sasia e ujit në komunën e Kaçanikut është e tepruar, por nuk menaxhohet. Tani edhe aksione nuk kemi, e sqaroj edhe drejtori, por me ngitë zërin edhe ne si Ekzekutiv edhe ju si KK, me bërë zgjidhje. Fond kanë të mjaftueshme në nivel të Kosovës si ARU, por të ne nuk kanë pa të arsyeshme me investuar. Ne çdo vjet që po investojmë, astetet po ia dërgojmë kompanisë, me marrëveshje që me menaxhuar, nuk ka menaxhim, por nuk do të thotë se ne nuk duhet ngritur zërin. Krejt çka duam me bërë me telefonuar, se nuk ka ujë në Doganaj, Kaçanik, e shumë fshatra tjera, në Kaçanik të Vjetër, është prishur pompa. Në KRU “Bifurkacioni” na kanë thënë se nuk ka rezerva e duhet me pritur në procedurë të prokurimit. Çështja është se duhet me bërë zgjidhje.

**znj. Ardita Rrahmani:** A ka ndonjë lokalitet në Komunën e Kaçanikut që i përmbushë kërkesat dhe nevojat në raport me ujin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për mua nuk ka pasur problem me ia shkruar një email, por ia kam lënë drejtorit të DSHPE, që është me kompetent dhe në raport me ta, por përsëri e ka konfirmuar se nuk kemi të drejtë me ardhur me raportuar në KK. Ne po iu bëjmë thirrje për një takim kur ata që janë të gatshëm. Në atë takim do të marrim pjesë: SHGP, Kryetari apo Nënkryetari dhe unë si kryesues i KK. Në këtë rast e kisha bërë një përjashtim, që të jetë edhe Bashkim Krasniqi nga PDK se e përfaqëson një rajon të madh, Kaçanikun e Vjetër dhe Begracë, se ne të tjerët i mbulojmë disa territore, të caktojmë një takim, të shohim se çka mundemi me bërë me shtyrë përpara këtë çështje. Komuniteti ka shprehë vullnetin me i shkëputë marrëveshjet.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Unë jam me marrë pjesë vetëm shefat e GP, përndryshe të shtohet edhe nga një anëtarë nga secili subjekt politik.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë jam që të merr pjesë SHGP +1 nga secila parti, që me munguar ndonjëri, është anëtari tjetër që përfaqëson subjektin politik.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk kanë edhe shumë vend atje, kështu që të shkojmë shefat e GP.

**znj. Ardita Rrahmani:** Takimi mundet me u mbajtur edhe këtu në Kaçanik.

**z. Ramadush Osmani:** Kryeshefi Ekzekutiv i KRU ”Bifurkacioni” i raporton Bordit të ndërmarrjes. E keni pa që unë kam kërkuar takim me Kryeshefin dhe Bordin e ndërmarrjes. Bordi i drejtorëve e sheh të arsyeshme të emëroj dhe shkarkoj kryeshefin ekzekutiv. Si institucion, mendoj se ne duhet të takohemi me Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Atëherë kështu të mbetet, takimin e fton drejtori i DSHPE. Në bazë të diskutimeve, del konstatimi,

**Kërkesë për një takimi urgjent për çështjen e menaxhimit të ujit**

Me Menaxhmentin dhe Bordit udhëheqës të KRU ”Bifurkacionit” sh.a. Në atë takim do të marrin pjesë Shefat e grupeve të KK Kaçanik, Kryetari apo Nënkryetari i Komunës, Drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

